



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE GJILAN

---

Numri i lëndës: 2019:087961  
Datë: 17.04.2019  
Numri i dokumentit: 00281024

**CN.nr.268/2018**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni civil,** gjyqtarja Mevlide Shabani, me bashkëpunëtorin profesional Baki Sylejmani, duke vendosur në procedurën jokontestimore të propozuesit të sigurimit-Agjencia Kosovare e Privatizimit-ZR Gjilan Autoriteti i Likuidimit, për NSh. “Kombinati i Duhanit” në Gjilan, të paraqitur kundër kundërshtarit të sigurimit- kundërpropozueses Komunës së Gjilanit, lidhur me propozimin për caktimin e masës së përkohshme, jashtë seancës gjyqësore, me datë 09.01.2019, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. APROVOHET SI I BAZUAR** propozimi i propozueses të sigurimit Agjencia Kosovare e Privatizimit - ZR Gjilan -Autoriteti i Likuidimit, për NSh. “Kombinati i Duhanit” në Gjilan, dhe **CAKTOHET MASA E PËRKOSHME E SIGURIMIT**, me të cilën i **NDALOHET** kundërpropozuesit-kundërshtarit të sigurimit Komunës së Gjilanit, vazhdimi i punimeve në projektin e zgjerimit/ndërtimit të rrugës në kuadër të parcelës kadastrale P-70403013-02682 në sipërfaqe prej 348 m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale në Gjilan, me kulturë jopjellore, në vendin e quajtur “Bregu i Djegur” dhe të parcelës kadastrale P-70403013-02684-4 në sipërfaqe prej 1351 m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale në Gjilan, me kulturë jopjellore, në endin e quajtur “Bregu i Djegur”, të cilat evidentohen në emër të PSH.”Kombinati i Duhanit” në Gjilan.

**II.** Masa e Përkohshme do të mbete në fuqi deri në zgjidhjen definitive të çështjes kryesore.

**III.** Obligohet propozuesi i sigurimit që konform nenit 308.1 të LPK-ës brenda afatit prej 30 ditësh të paraqes padi në këtë Gjykatë.

**IV.** Njoftohet propozuesi i sigurimit që këtë vendim personalisht ta regjistrojë në DGJKP në Gjilan, sipas procedurës administrative.

**V.** Kundërshtimi eventual apo ankesa nuk e ndalojnë ekzekutimin e vendimit.

**A r s y e t i m**

Propozuesja Agjencia Kosovare e Privatizimit-ZR në Gjilan-Autoriteti i Likuidimit, për NSh.”Kombinati i Duhanit në Gjilan, në këtë gjykatë me dt.13.11.2018 ka paraqitur propozim për caktimin e masës së përkohshme, ndaj kundërpropozueses Komunës së Gjilanit, duke kërkuar nga Gjykata që të **CAKTOHET MASA E PËRKOSHME E SIGURIMIT** dhe ti **NDALOHET** kundërpropozuesit-kundërshtarit të sigurimit Komunës së Gjilanit vazhdimi i punimeve në projektin e zgjerimit/ndërtimit të rrugës në kuadër të parcelës kadastrale P-

70403013-02682-2 në sipërfaqe prej 348 m2, Zona Kadastrale në Gjilan, me kulturë jopjellore, në vendin e quajtur “Bregu i Djegur” dhe të parcelës kadastrale P-70403013-02684-4 në sipërfaqe prej 1351 m2, Zona Kadastrale në Gjilan, me kulturë jopjellore, në endin e quajtur “Bregu i Djegur”.

Propozuesja në propozim ka theksuar se Ndërmarrja Shoqërore “Kombinati i Duhanit” në Gjilan është regjistruar në Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Prishtinë dhe në mbështetje të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit me të gjitha pasuritë e saja është nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Ndërmarrja Shoqërore “Kombinati i Duhanit”, është pronare e vetme e pasurisë së paluajtshme, të parcelës kadastrale P-70403013-02682-2 në sipërfaqe prej 348 m2, Zona Kadastrale në Gjilan, me kulturë jopjellore, në vendin e quajtur “Bregu i Djegur” dhe parcelës kadastrale P-704093013-02684-4, në sipërfaqe prej 1351 m2 Zona Kadastrale në Gjilan, me kulturë jopjellore, në vendin e quajtur “Bregu i Djegur”, ndërsa kundërpropozuesja Komuna e Gjilanit, në parcelat e lartcekura pronë të kësaj ndërmarrje ka filluar projektin e ndërtimit/zgjerimit të rrugës, dhe vendosjen e infrastrukturës përcjellëse, pa dijeninë e lejen e ndërmarrjes.

Për ti vërtetuar thëniet e tyre propozuesi gjykatës i ka paraqitur këto prova dhe ate :

Certifikatat mbi të drejtat e pronës së paluajtshme ku figuron se këto palujatshmëri evidentohen në emër të Ndërmarrjes shoqërore “Kombinati i Duhanit”, Ortofoto,, Fotot nga vendi i ngjarjes si dhe Vendimi i Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë Fi-729/89.

Gjykata pas shikimit të shkresave të lëndës, propozimit të propozuesit të sigurimit për caktimin e masës së përkohshme, provave të propozuara, gjeti se propozuesi i sigurimit e ka bërë të besueshëm të drejtën e tij subjektive, pasi që ekziston dyshimi se kundërpropozuesi-kundërshtari i sigurimit Komuna e Gjilanit pa dijeninë e saj ka filluar projektin e ndërtimit zgjerimit të rrugënë dhe vendosjen e infrastrukturës, kurse neni 297 i Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), ka paraparë se *“Masa e sigurimit mundë të caktohet në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshëm ekzistimin e kërkesës apo të drejtës së tij subjektive, apo në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të mund të pamundësonte apo vështirsonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vetë, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do të ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit”*, ndërsa Neni 304.3 i LPK-së, në mes tjerash, ka paraparë ***“Propozuesi në propozimin e tij duhet t’i tregoj edhe faktet mbi të cilat mbështetet kërkesa e tij si dhe që këto “mjete provuese t’ia bashkangjesë propozimit”***, gjë te cilën propozuesi e ka bërë me dorëzimin e provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Andaj, Gjykata duke vendosur sipas propozimit të propozueses të sigurimit të dt. 13.11.2018, të njëjtin propozim e aprovoi si të bazuar me dispozita ligjore, ngase propozuesi i sigurimit propozimin e tij për caktimin e Masës së Përkohshme e ka mbështetur me prova (të dorëzuar deri në këtë fazë të procedurës) me të cilat është bërë e besueshme e drejta subjektive si dhe fakti se pa caktimin e masës së tillë do të rrezikohet zgjidhja normale e kësaj qështje.

Andaj, meqë propozuesi i sigurimit e ka bërë të besueshëm të drejtën e tij subjektive dhe faktin tjetër se pa caktimin e masës së përkohshme, do të pësonte dëm të pariparueshëm si dy elemente që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimit.

Nga sa u tha më lartë, e konform nenit 297.1 pika a) dhe b), 303.4, 306.2 dhe 308.1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK) lidhe me nenin 3 të Ligjit të Procedurës Jokontestimore, kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Gjyqtarja**

**Mevlide Shabani**

Numri i lëndës: NumriLëndës  
Datë: DataDokumentit  
Numri i dokumentit: NumriDokumentit

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet prapësim në Gjykatën Themelore në Gjilan në afate prej 3 ditësh pas ditës së pranimit të vendimit.